



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**V E N D I M**

**Nr. 6, datë 17.01.2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PËRBASHKËT TË PRANIMIT, DAKORDËSUAR MIDIS INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË DHE MAGJISTRATES ZNJ. {...}, ME FUNKSION GJYQTARE NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSORË ELBASAN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 140, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 135 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 86, shkronja “e” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, shqyrtoi kërkesën lidhur me procedimin disiplinor 03/2021, që i përket:

**KËRKUES:** Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. {...}.

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:** Magjistrate, Znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**OBJEKTI I KËRKESËS:** Miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit me magjistraten znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**BAZA LIGJORE:** Neni 103, shkronja “dh”, neni 105, pika 1, shkronja “d”, neni 110 dhe neni 135 i Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Seksioni “C”, shkronja “a” dhe “b” dhe Seksioni “Ç”, pika 9, shkronja “c”, i Kodit të Etikës Gjyqësore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancën dëgjimore të datës 17.01.2022, sipas parashikimeve të neneve 135, 142 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe dëgjoji:

- **Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, z. {...}**, i cili përfundimisht kërkoi miratimin e “Marrëveshjes së përbashkët të pranimit”, të nënshkruar nëpërmjet magjistrates, znj. {...}, dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke caktuar ndaj magjistrates masën disiplinore “Pezullim si masë disiplinore”, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj;
- **Magjistraten, znj. Enkelejda {...}**, e cila shprehu dakordësinë për arritjen e “Marrëveshjes së përbashkët të pranimit”, duke kuptuar kushtet e parashikuara në këtë marrëveshje dhe i kërkoi Këshillit të pranonte përmbajtjen e marrëveshjes së arritur midis palëve.

### V Ë R E N:

1. Magjistratja, znj. {...}, ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan si dhe ka ushtruar detyrën e Zëvendëskryetares pranë kësaj gjykate prej datës 30.09.2020. Në datë 01.06.2021, Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën për fillimin ndaj magjistrates të procedimit disiplinor<sup>1</sup>, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja ”a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 103, shkronja “dh” e Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Seksioni “C”, “Parimi i integritetit”, shkronja “a” dhe “b”, Seksioni “Ç” “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbajtje”, pika 9, shkronja “c” i Kodit të Etikës Gjyqësore<sup>2</sup>. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë të Drejtësisë fillimisht ka paraqitur dhe propozimin për caktimin ndaj magjistrates të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja ”a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 105, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 1 e Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (referuar në vijim si “Ligji për Statusin”).

2. Bashkë me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka depozituar dhe kërkesën me objekt, “Për pezullimin nga detyra e magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor”<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Shkresa nr. 2596/12 prot., datë 01.06.2021 e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, protokolluar me aktin nr. 2508/3, datë 01.06.2021 në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

<sup>2</sup> Miratuar me vendimin nr. 171, datë 22.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

<sup>3</sup> Shkresa nr. nr. 2569/13 prot., datë 01.06.2021, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, protokolluar me aktin nr. 2508/4, datë 01.06.2021.

3. Nga aktet e dosjes hetimore rezulton se fillimi i hetimit disiplinor është vendosur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (më poshtë referuar dhe si ILD), me Vendimin nr. 2569 prot., datë 31.05.2021, bazuar në nenet 124 dhe 152 të Ligjit për Statusin. Referuar këtij vendimi, si shkak për fillimin me iniciativë të hetimit disiplinor, kanë shërbyer disa video të magistrates, të publikuara në rrjetin social “Tik-Tok”, të cilat më pas janë publikuar në datat 30 dhe 31 Maj 2021, në median e shkruar dhe atë vizive, si dhe në rrjetet sociale, shoqëruar me lajme e tituj të ndryshëm për magistraten znj. {...}.

4. Pas depozitimit të kërkesave, Këshilli i Lartë Gjyqësor nisi menjëherë shqyrtimin e tyre ku fillimisht, pas shortit të hedhur, bazuar në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. 222, datë 02.06.2021, si relator për procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...}, u caktua anëtari i Komisionit Disiplinor, z. Maksim Qoku<sup>4</sup>.

5. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, duke mos konstatuar mangësi të tij dhe as ekzistencën “*prima facia*” të ndonjë prej rasteve për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, të përcaktuara në nenin 138 të Ligjit për Statusin, relatori i çështjes i propozoi Këshillit të Lartë Gjyqësor të vijonte me shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për pezullimin e përkohshëm nga detyra të magistrates.

6. Në kushtet kur procedimi disiplinor u paraqit sipas nenit 152, pika 1, të Ligjit për Statusin, ndërsa pika 2 e kësaj dispozite përcakton detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për shqyrtimin e kërkesës për pezullim e përkohshëm nga detyra të magistratit të proceduar disiplinorisht brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj, kjo kërkesë u shqyrtua në Mbledhjen Plenare të datës 7 Qershor 2021, në të cilën, me vendimin nr. 240, datë 07.06.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

*“1. Pezullimin nga detyra të magistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor, iniciuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2569/12, datë 01.06.2021.*

*2. T’i kërkohet ILD të kryejë hetime të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore të atribuuar magistrates zonjës{...}.*

*3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*

*4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magistrates {...}, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publike në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

---

<sup>4</sup> Ky vendim iu njoftua palëve, me Shkresën nr. 2543/2 prot., datë 03.06.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga znj.Kapedani, në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila me vendimin e saj nr. 66, datë 04.10.2021, ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke rrëzuar padinë e paraqitur nga magjistratja.

7. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka shqyrtuar të dhënat e raportit të hetimit, dosjes hetimore dhe ka dëgjuar pretendimet e magjistrates në seancë dëgjimore, ndër të tjera, ka vlerësuar hetimin disiplinor si të pamjaftueshëm për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe të rregullt mbi procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates, duke i kërkuar ILD-së kryerjen e hetimeve të mëtejshme në drejtim të fakteve dhe rrethanave objekt të procedimit disiplinor.

8. Bazuar në kërkesën e Këshillit për kryerje të hetimeve të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore të atribuar magjistrates, ILD, me vendimin nr. 2569/22 prot., datë 22.09.2022, ka vendosur vazhdimin e hetimit disiplinor ndaj saj, në kryerjen e veprimeve dhe marrjen e provave të kërkuara.

## **I. DAKORDËSIMI I MARRËVESHJES SË PËRBASHKËT TË PRANIMIT GJATË HETIMIT DISIPLINOR**

9. Në datë 30.09.2021, magjistratja, znj. {...}, ka depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kërkesën e saj për arritjen e një marrëveshjeje midis palëve, me anë të së cilës ajo shprehte qëndrimin e saj lidhur me shkeljen disiplinore dhe vlerësonte se në rastin konkret plotësoheshin kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara nga neni 135 i Ligjit për Statusin. Në analizë të këtyre kriterëve, si dhe nga hetimi disiplinor i kryer, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u evidentuan një sërë rrethanash të cilat nuk kishin ekzistuar gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor fillestar, të cilat i kishin diktuar atij dakordësimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit me magjistraten.

10. Këto rrethana kishin të bënin me:

(i) paraqitjen e kërkesës nga ana e magjistrates për dakordësimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit lidhur me rrethanat e faktit, rëndësisë së shkeljes disiplinore, apo llojin e masës së disiplinore;

(ii) qëndrimin e magjistrates, i cili është i ndryshëm nga qëndrimi mohues lidhur me shkeljen disiplinore i mbajtur gjatë procedimit fillestar disiplinor, duke marrë përsipër peshën e përgjegjësisë morale, kërkuar ndjesë, si dhe duke shfaqur pendesë lidhur me aktet e kryera nga ana e saj;

(iii) depozitimim e dorëheqjes me shkrim nga pozicioni i Zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan si shenjë e thellë reflektimi ndaj shkeljes disiplinore të kryer nga ana e saj;

(iv) periudhën e pezullimit të magjistrates, që i ka shërbyer asaj për të reflektuar thellë rreth situatës dhe vërtet të ndiejë një peshë përgjegjësie dhe përgjegjshmërie për atë çfarë ka ndodhur, duke e bërë më të kujdesshme në jetën e saj private;

(v) bashkëpunimin e magjstrates me Zyrën së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pavarësisht kompleksitetit të çështjes lidhur me vërtetimin e rrethanave të faktit të shkeljes disiplinore, si dhe pamundësisë së vërtetimit të tyre, duke u paraqitur, përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave, si dhe duke mos qenë pengesë lidhur me vazhdimin e hetimeve, apo vënien në dispozicion të ILD-së të mjeteve apo informacionit të nevojshëm;

(vi) ekzistencën e rrethanave lehtësuese të parashikuara nga neni 115, pika 3, shkronjat "a", "c", "dh" dhe "e" të Ligjit për Statusin;

(vii) zhvillimin e një procedure administrative sa më të shpejtë dhe efektive në kuadër të procedimit të shkeljeve disiplinore me anë të nënshkrimit të marrëveshjes së përbashkët të pranimit.

11. Në datë 05.01.2022, rezulton se midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjstrates, znj. {...}, është nënshkruar me aktin nr. 2569/45 prot., “Marrëveshja e përbashkët e pranimit”, ku palët kanë rënë dakord për rrethanat e faktit, llojin e shkeljes disiplinore, të pranuar nga magjistratja, dhe masën disiplinore të përshtatshme.

12. Në bazë të marrëveshjes së pranimit të dakordësuar nga palët, rezultoi se gjatë hetimit disiplinor, ishin mbledhur të dhëna të rëndësishme në lidhje me rrethanat e faktit që i atribuohen magjstrates, të cilat janë si vijon:

*12.1 Magjistratja znj. {...} është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me Dekretin nr. 9236, datë 25.09.2015. Më datë 30.09.2020, znj. {...} është zgjedhur në pozicionin e Zëvendëskryetares nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të kësaj gjykate. Me mbarimin e statusit të magjistratit me dorëheqje të kryetarit në detyrë, magjistratja në cilësinë e Zëvendëskryetares së Gjykatës, ushtronte edhe detyrat e Kryetarit. Për shkak të ushtrimit të këtij funksioni, nga ana e saj përdorej si zyrë, pikërisht zyra e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ndodhet në katin e tretë të godinës së gjykatës dhe asistojë nga sekretarja gjyqësore V.K, e cila përdorte si ambient pune paradhomën e Kryetarit.*

*12.2 Nga këqyrja e bërë videove, të publikuara në rrjetin social “Tik-Tok”, në muajin Maj të vitit 2021, provohet se nga ana e saj është përdorur ambienti i Zyrës së Kryetarit, si dhe ambienti nga ashensori i të njëjtit kat dhe korridori, i cili lidh ashensorin me zyrat e gjyqtarëve dhe me Zyrën e Kryetarit, për të realizuar video të imazhit të saj personal, me lëvizje dhe sjellje provokuese, të shoqëruar në sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme për imazhin e një magjistrati.*

*12.3 Videot e realizuara në këto ambiente të Zyrës së Kryetarit dhe të ambienteve të tjera të Gjykatës, janë hedhur në rrjetin social “Tik-Tok”, në llogarinë e hapur me të dhënat “@kapedani333”, në data të ndryshme si: 14.05.2021, 17.05.2021 dhe 20.05.2021. Magjistratja pohon të ketë realizuar ajo vetë videot në ambientet e Zyrës së Kryetarit pas fillimit të ushtrimit të funksioneve të Kryetarit, të cilat janë publikuar në rrjetin social "Tik Tok" në muajin Maj të vitit 2021. Magjistratja pohon se i ka realizuar me aparatën e saj celular, e nxitur nga euforia për*

detyrën e ngarkuar dhe krenaria për veten. Qëllimi ka qenë i momentit dhe thjesht për t'ia treguar familjarëve pjesën e zyrës.

12.4 Magjistratja është pyetur mbi preferencat e saj muzikore, duke patur parasysh këngën me titullin “Mafia” dhe fjalorin që përdoret në këtë tekst, apo në këngët të cilat shoqërojnë pamjet në video. Ajo ka deklaruar se nuk janë ato preferenca të saj dhe se në fillim dinte shumë pak, ndonjë fjalë të tekstit të këngës, ndërsa pas gjithë kësaj ngjarje është interesuar për të dëgjuar gjithë këngën, por ka patur shumë vështirësi në identifikimin e tekstit prej llojit të gjuhës së përdorur. Aludimi fillestar i magjistrates, se mund të ketë modifikim të këngëve, sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk qëndron për faktin se nga pamjet video është lehtësisht e konstatueshme se gjyqtarja e njeh tekstin e këngës “Mafia”, të cilin jo vetëm që e këndon, por e shoqëron edhe me gjestikulacione të buzëve dhe të duarve që dukshëm ndjek fjalët e tekstit e të muzikës, çfarë tregon se gjyqtarja është e familjarizuar me atë këngë dhe e këndon atë.

12.5 Nga këqyrja e pamjeve të videove të publikuara, shihet se Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, performon në zyrën e saj, ku ndodhen dosje për shqyrtim, pelerina e gjyqtarit, pjesë e veshjes në funksion të solemnitetit të detyrës. Ajo kujdeset të bëjë një panoramim në sfond të ambienteve të zyrës, performon dhe duar dhe me flokët e saj, pamje të cilat janë pranuar si jo të denja për detyrat që ajo mbante. Gjyqtarja kujdeset të tregojë në këtë sfond, pjesë të ndryshme të trupit, ndërsa në sfond është kënga “Mafia, Mafia”, mesazhi i të cilës në thelb pranohet se është mbështetje për krimin dhe drogën, ndërsa në tekst, nuk mungojnë as fjalë banale, për sa kishte rezultuar dhe nga zbardhja e tij në kuadër të detyrave shtesë të lëna nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 240, datë 07.06.2021. Teksa gjyqtarja merr poza për të dalë sa më hijshëm në video, kënga vijon me fjalët “Mafi, Mafi, Mafia, Rrethi jem o mafios” (citim).

12.6 Magjistratja gjatë pyetjes së realizuar nuk ka identifikuar personin tjetër, i cili realizon videon, që shfaq pamje nga dalja e saj nga ashensori, deri në momentin e uljes në karrigen e Zyrës së Kryetarit, ndërsa pyetjes së inspektorëve, se a mund të ishte punonjësi gjykatës, i është përgjigjur me shprehjen evazive “ndoshta”. Sipas ILD-së, nga kontakti që inspektorët morën me sekretaren gjyqësore të Zëvendëskryetares së Gjykatës, znj. V.K dhe krahasuar imazhi i saj, me imazhin që projektohet në pasqyrën e ashensorit, atyre iu krijua bindja se është ajo personi, i cili ka realizuar këtë video, teksa ndjek Zëvendëskryetaren e Gjykatës në paradën që ajo bën në ambientet e korridorit, deri në uljen e saj në Zyrën e Kryetarit. Kjo bindje e inspektorëve nuk u pohua nga asnjë prej personave të pyetur, as drejtpërsëdrejti nga magjistratja, e as sekretarja e saj gjyqësore, me të cilën ajo ka punuar nga koha e emërimit të saj për herë të parë në Gjykatën e Elbasanit në vitin 2015, çfarë tregon, sipas ILD-së, edhe afrimitetin, që mund të ekzistojë midis tyre. Si rrjedhojë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludon se subjekti i hetimit disiplinor për të realizuar videot, ka përdorur edhe persona të tjerë, potencialisht punonjës të administratës, duke përdorur pozitën e saj për realizimin prej tyre, të videove të vetë Zëvendëskryetares.

13. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistratja znj. {...} kanë rënë dakord se të dhënat e mbledhura çojnë në përfundimin se gjyqtarja ka kryer shkeljet e mëposhtme të pranuar nga ana e saj, si vijon:

*13.1 Nga ana e magjistrates, znj. {...}, ka shkelje të parimit të integritetit i parashikuar në Kodin e Etikës Gjyqësore, Seksioni "C", "Parimi i integritetit", shkronja "a" dhe "b". Në videot e transmetuara nuk rezulton, që magjistratja të kujdeset për ruajtjen e këtij integriteti, pavarësisht pretendimit të saj, se videot janë bërë jashtë orarit zyrtar. Për shkak të funksionit që gjyqtari ka, duhet të ushtrojë kujdes në ruajtjen e integritetit të tij, si gjatë ashtu edhe jashtë ushtrimit të funksionit. Ky kujdes nuk duhet të tregohet vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, brenda orarit zyrtar, por dhe jashtë tij, edhe në jetën private, në ambiente private, sikundër mund të jetë edhe automjeti, për më tepër, se pavarësisht pretendimit si të realizuara jashtë orarit zyrtar, ato janë realizuar në ambiente ku ushtrohet veprimtaria e Zëvendëskryetarit të Gjykatës, si drejtues i saj dhe si përfaqësuesi më i lartë me të tretët.*

*13.2 Pamjet e publikuara, të cilat janë realizuar si nga vetë magjistratja, apo dhe nga të tjerë, si në ambientet e zyrës, në ambientet e tjera të gjykatës, si dhe në automjet, nuk janë aspak dinjitoze në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm dhe konfirmojnë një sjellje të pahijshme të Zëvendëskryetares së Gjykatës, të realizuar me dashje direkte.*

*13.3 Në rastin konkret, provohet gjithashtu shkelja e parimit të sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbajtje të parashikuar në pikën 9, shkronja "c" të Kodit të Etikës Gjyqësore, pasi magjistratja ka përdorur zyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës për të reklamuar veshjen, pamjen, kurimin e imazhit të saj, të shoqëruar me sjellje e veprime të pahijshme pa asnjë lloj vetëpërmbajtje, referuar vendit ku ato janë realizuar, duke arritur të krijojë një disbalancë mes të drejtave të saj si qytetare për të realizuar video të saj apo për të kënduar dhe kufizimeve që lidhen me funksionin e saj jo vetëm si gjyqtare, por edhe Zëvendëskryetare e Gjykatës.*

*13.4 Provohet plotësisht se "Parimi i Integritetit" i parashikuar në pikën 8, shkronjat "a" dhe "b" si dhe "Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbajtje" të parashikuar në pikën 9, shkronja "c" të parashikuar në Kodin e Etikës Gjyqësore, të jenë shkelur në mënyrë të përsëritur nga ana e magjistrates, znj. {...}.*

*13.5 Funkzioni kryesor i një magjistrati është dhënia e drejtësisë ndaj shkelësve të ligjit dhe personave që kryejnë vepra të dënueshme sikundërse janë veprat penale të lidhura me krimin dhe drogën. Kjo dhënie drejtësie jo vetëm duhet të jepet, por dhe duhet të perceptohet nga publiku i gjerë se jepet, ndërsa sjellja e Zëvendëskryetares në atë kohë të Gjykatës, znj. {...} në këto video, referuar edhe tekstit të këngës që ajo këndon në zyrën ku ushtron veprimtarinë, është perceptuar nga publiku i gjerë si sjellje aspak e denjë për funksionin që ajo ushtron, pozicionin që përfaqëson, apo si sjellje që dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor.*

13.6 Këto sjellje dhe veprime të magistrates të kryera jashtë ushtrimit të detyrës, por në ambientet e ushtrimit të detyrës, janë sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magistratit dhe dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, duke u parashikuar si shkelje disiplinore në nenin 103, paragrafi 1, shkronja "dh" e Ligjit për Statusin.

13.7 Nga akti i ekspertimit i kryer mbi telefonin celular me të cilin janë realizuar videot objekt hetimi si dhe nga këqyrja e kamerave të sigurisë që monitorojnë ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk rezultuan të dhëna të vlefshme, si rrjedhojë në këtë kuadër, në zbatim të parimit se çdo dyshim është çmuar se shkon në favor të magistratit, u vlerësuan se mbetet e paprovuar shkelja e atribuuar fillimisht magistrates në vendimin e hetimit disiplinor, e parashikuar në shkronjën "k" të pikës 9 të Kodit të Etikës Gjyqësore, ajo e përdorimit me vetëpërmbajtje të medias dhe rrjeteve sociale.

14. Sipas nenit 105 të Ligjit për Statusin, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe gjyqtarja, znj. {...}, kanë rënë dakord për masën disiplinore "Pezullimi si masë disiplinore" me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja "d" dhe neni 110 i ligjit, sipas arsytimit të vendosur në marrëveshjen e pajtimit, ku ndër të tjera dakordësohet se:

14.1 Në analizë të kriterit "mbi llojin dhe rrethanat e shkeljes" rezulton se në të gjitha videot e publikuara, magistratja ka sjellje të padenja, të pahijshme, pa vetëpërmbajtje, në mungesë integriteti, në shkelje të parimit të garantimit të besimit të publikut tek drejtësia. Këto shkelje të konstatuara janë vlerësuar të një natyre të tillë që magistratja duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.

14.2 Në analizë të kriterit të "shkallës së fajësisë dhe motivi", rezulton se shkeljet disiplinore nga ana e magistrates janë kryer me dashje direkte. Magistratja ka realizuar të gjitha këto video në ambientet e zyrës së Kryetarit të Gjykatës në vullnet të plotë, me dashje, e vetëkënaqur me imazhin e filmuar, me tekstin e këngës që shoqëron në sfond, me shkrimet që shoqërojnë videot e publikuara, apo me reklamimin e firmave të veshjeve të saj. Në videot e xhiruara nga vetë ajo gjatë drejtimit të automjetit tip BMW, konstatohet edhe shkelja administrative e mungesës së rripit të sigurimit, e cila është vlerësuar si sjellje, që lidhet respektimin e detyrimeve ligjore nga ana e magistrates, pasi në ushtrim të kompetencave gjyqësore mund të gjykojë vetë, çështje të kësaj natyre.

14.3 Në analizë të kriterit "pasojë e shkeljes" të sjelljes dhe veprimeve të pahijshme të magistrates, cenimit të integritetit të magistratit, rezulton se si pasojë e veprimeve/mosveprimeve të kryera nga ana e magistrates ka ardhur diskretitimi i pozitës dhe figurës së magistratit, si dhe dëmtimi i besimit të publikut te drejtësia.



14.4 Përdorimi i zyrës së kryetarit nga subjekti i hetimit disiplinor, cila është njëkohësisht dhe zyra më e lartë e institucionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si ambient për të reklamuar, veshjen, ecjen, imazhin, si dhe në përdorim të gjesteve, fjalëve dhe lëvizjeve të hijshme për një gjyqtare e jo më për një drejtuese të institucionit, ka cënuar besimin edhe të një vëzhguesi të zakonshëm tek ky institucion në dhënien e drejtësisë.

14.5 Ngjarja, duke marrë edhe jehonë mediatike, u përdor si shembull për etiketimin e sjelljeve negative të anëtarëve të gjithë gjyqësorit në Shqipëri. Mediat përmes raportimeve, analizave apo emisioneve të posaçme ndoqën me vëmendje dhe shqetësim sjelljen e pahijshme dhe të papërshtatshme të magistrates. Rrjedhimisht, sjellja konkrete e magistrates ndikoi në uljen e besimit publik tek sistemi gjyqësor.

14.6 Në analizë të kriterit "masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore" në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se sjellja e papërshtatshme e magistrates subjekt hetimi disiplinor nuk është shtrirë vetëm tek magistratja, por mund të krijojë terren për sjellje të papërshtatshme edhe në rastet të tjera të ngjashme. Fakti se kjo sjellje është kryer nga ana drejtuese së gjykatës, në zyrën e Kryetarit të Gjykatës, si dhe ambiente të tjera, ekziston rreziku që të ndiqet edhe nga magistratë të tjerë të të njëjtës gjykatë, çfarë nënkupton dhe rëndësinë thelbësore që ka sjellja e drejtuesit jo vetëm në ambientet e gjykatës, por dhe jashtë saj.

14.7 Ndërsa në analizë të kriterit "sjellja e magistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit" apo "sjellja e magistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij", rezulton se në fillim sjellja e saj ka qenë mohuese në drejtim të llojit të shkeljeve që i adresohen me pretendimin se janë jashtë orarit zyrtar, si dhe nuk janë përdorur dosje, veshje apo simbole që lidhen me ushtrimin e funksionit të magistratit. Pas depozitimit të kërkesës së ILD-së, gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në Këshillin e Lartë Gjyqësor gjyqtarja znj. {...} paraqiti dorëheqjen nga detyra e Zv.Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe kërkoi ndjesë publike.

14.8 Pas fillimit të hetimit disiplinor dhe gjatë hetimit të kryer gjyqtarja ka marrë përsipër peshën e përgjegjësisë morale, si dhe ka kërkuar ndjesë. Gjyqtarja ka pohuar se në çastet e para është gjendur përballë një presioni shumë të madh psikologjik, familjar, mediatik dhe institucional, të cilat në tërësinë e tyre ndikuan edhe aftësinë e saj për të perceptuar realitetin dhe mënyrën e reagimit ndaj saj. Magistratja ka deklaruar se periudha e pezullimit deri më sot i ka shërbyer për të reflektuar thellë rreth situatës dhe vërtet të ndjejë një peshë përgjegjësie dhe përgjegjshmërie për atë çfarë ka ndodhur, duke e bërë më të kujdesshme, në mos hermetike në jetën e saj private.

14.9 Janë vlerësuar si rrethana lehtësuese në kushtet e parashikuara nga neni 115, pika 3, shkronjat "a", "c", "dh" dhe "e" të Ligjit për Statusin, qëndrimi bashkëpunues i magistrates lidhur me vazhdimin e hetimeve, koha e kaluar nga kryerja e shkeljes, fakti që nuk ka shkelje

*disiplinore të mëparshme, si dhe rrethana të tjera si niveli profesional, efektiviteti dhe eficensa në punë e magjistrates.*

*14.10 Referuar nenit 115, pika 2 dhe 4, shkronja "b" të Ligjit për Statusin, vlerësohet si rrethanë rënduese vazhdimësia e shkeljes. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit disiplinor provohet se kjo sjellje dhe qëndrim të jetë në video të ndryshme të realizuara në ditë të ndryshme, në ambiente të ndryshme. Konstatohet se ka sjellje, të cilat realizohen edhe në prani të një të mituri, i cili ndodhet në sediljen e pasme të automjetit, ndërsa gjyqtarja është pasagjere.*

*14.11 Duke mbajtur në konsideratë të gjithë elementët e analizuar në marrëveshje arrihet në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates, znj. {...}, përbëjnë "Shkelje shumë të rëndë disiplinore". Në analizë të çështjes lidhur me "llojin e masës së disiplinore", palët kanë rënë dakord për caktimin ndaj magjistrates të masës disiplinore "Pezullim si masë disiplinore" me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja "d" dhe neni 110 i Ligjit për Statusin.*

15. Me anë të shkresës nr. 2569/47 prot., datë 05.1.2022, ILD ka përcjellë në Këshill marrëveshjen e përbashkët të pranimit, regjistruar me nr. 2508/14 prot., datë 06.01.2022, së bashku me Raportin nr. 2569/44 prot., datë 05.01.2022 "Për Hetimin disiplinor të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Elbasan", dhe Vendimin nr. 2569/46, datë 05.01.2022, "Për përfundimin e hetimit disiplinor me marrëveshjen e përbashkët të pranimit me magjistraten {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Elbasan".

## **II. PROCEDURA E NDJEKUR NGA KËSHILLI**

16. Pas depozitimit të kërkesës së ILD-së për miratimin e "Marrëveshjes së përbashkët të pranimit", në datë 06.01.2022, me nr. 2508/15 prot., është depozituar edhe kërkesa me shkrim e magjistrates znj. {...}, duke parashtruar se gjatë procedurës administrative nga ana e saj janë paraqitur paraprakisht mendimet dhe shpjegimet e saj dhe se shprehte dakordësinë për vijimin e procedimit disiplinor me caktimin e seancës dëgjimore të radhës për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të arritur midis saj dhe ILD-së.

17. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vijim të shqyrtimit të kësaj çështje në seancë dëgjimore nga data 07.06.2021, caktoi datën 17.01.2022, si datë për zhvillimin e seancës dëgjimore të radhës, datë e cila iu njoftua palëve rregullisht.

18. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, relatori i çështjes i propozoi Mbledhjes Plenare, të vijonte me shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit me magjistraten znj. {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Seanca dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës, u zhvillua në prani të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. {...} dhe të magjistrates së proceduar disiplinorisht, gjyqtares znj. {...}.

### **III. PARASHTRIMET E PALËVE NË SEANCË DËGJIMORE**

19. Inspektori i Lartë i Drejtësisë parashitroi argumentet e tij mbi kërkesën për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit me magjistraten znj. {...}, duke pretenduar se magjistratja kishte depozituar pranë Zyrës së ILD-së “Kërkesë për arritjen e marrëveshjes”, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2569/27 datë 30 Shtator 2021. Nëpërmjet kërkesës për marrëveshje, magjistratja ka shprehur qëndrimin lidhur me shkeljen disiplinore dhe ka vlerësuar se në rastin konkret plotësoheshin kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara nga neni 135 i Ligjit për Statusin. Në këtë kuadër, ILD, duke mbajtur në konsideratë një sërë rrethanash të cilat nuk kanë ekzistuar gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor fillestar, ka përfunduar dhe finalizuar nënshkrimin të marrëveshjes së përbashkët të pranimit me magjistraten, znj. {...}.

20. Magjistratja, znj. {...}, parashitroi se ishte njohur me të gjithë veprimet dhe aktet e hetimit disiplinor. Gjatë hetimit disiplinor ajo kishte shprehur dakordësinë me vullnet të lirë për arritjen e “Marrëveshjes së përbashkët të pranimit”, ka kuptuar kushtet e saj, ka rënë dakord me kushtet e parashikuara në të, dhe i qëndron përmbajtjes së marrëveshjes së arritur midis palëve.

### **IV. LIGJI I ZBATUESHËM**

#### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

21. Në nenin 147, pika 1 sanksionohet se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë....”

22. Neni 147/d përcakton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

23. Neni 140 i Kushtetutës parashikon se: “1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. ...”

#### **Ligji për Statusin**

24. Në rastin konkret është i zbatueshëm edhe Ligji për Statusin, i cili në nenin 3, titulluar “Vlerat themelore”, parashikon se: “1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. 2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i

tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye. 3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij. 4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykim. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi”.

25. Në nenin 4 të ligjit, titulluar “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes”, parashikohet se: “1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit. 3. Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. 4. Secili Këshill emëron magjistratin si këshilltarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

26. Neni 101 i ligjit përcakton shkeljet disiplinore: “1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbytje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale. 2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh: a) shkalla e pakujdesisë; b) shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.”

27. Neni 103 i ligjit përcakton llojet e shkeljeve disiplinore të kryera jashtë ushtrimit të funksionit: “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: a) shkelja e rregullave të papajtuemshërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji; b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim

krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët; c) ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit; ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona; d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magjistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik; dh) raste të tjera të sjelljes që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.”

28. Në nenin 105 të ligjit të titulluar “Masat disiplinore”, parashikohet se: “1. Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore: a) vërejtje konfidenciale; b) vërejtje publike; c) ulje e përkohshme e pagës:i) deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit; ii) në rastin e magjistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës. ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër; d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave; dh) shkarkim nga detyra. 2. Në caktimin e masës disiplinore, Këshilli mund të vlerësojë çdo lloj pezullimi të mëparshëm sipas kreut V të kësaj pjese, që është vendosur gjatë procedurës përkatëse disiplinore, dhe mund të vendosë në mënyrë të përshtatshme një masë disiplinore më të lehtë ose që pezullimi është masa e përshtatshme dhe e mjaftueshme për shkeljen e kryer.”

29. Në nenin 110 të ligjit, titulluar “Pezullimi si masë disiplinore”, parashikon se: “Masa e pezullimit nga detyra e magjistratit, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, jepet vetëm në këto raste: a) kur shkelja është e shumë e rëndë; b) kur Këshilli çmon se, pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar.”

30. Në nenin 135, titulluar “Marrëveshje e përbashkët e pranimit”, parashikon se: “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit. 2. Palët mund të bien dakord për llojin e shkeljes disiplinore që magjistrati pranon, si dhe masën disiplinore të përshtatshme. 3. Palët hartojnë me shkrim dhe nënshkruajnë marrëveshjen, e cila dorëzohet në Këshillin përkatës. 4. Marrëveshja duhet të përmbajë: a) përmbledhje të fakteve dhe shkeljes që pranon magjistrati; b) masën disiplinore që palët kanë rënë dakord; c) një deklaratë se magjistrati është i vetëdijshëm se marrëveshja duhet të miratohet nga Këshilli. 5. Këshilli përkatës pranon marrëveshjen me

vendim të arsyetuar, nëse: a) marrëveshja është nënshkruar nga të gjitha palët dhe përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni; b) nëse rezulton se magjistrati e ka kuptuar marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj, si dhe nëse ai ka dhënë pëlqimin me shkrim me vullnetin e tij të lirë; c) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, të jenë në përputhje me këtë ligj. 6. Këshilli përkatës refuzon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse: a) marrëveshja nuk nënshkruhet nga të gjitha palët ose nuk përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni; b) magjistrati i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në seancë dhe nuk paraqet shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij; c) provat e mbledhura janë në kundërshtim haptazi me deklarinimin e magjistratit për pranimin e kryerjes së shkeljes disiplinore; ç) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, nuk janë në përputhje me këtë ligj; d) magjistrati është detyruar të pranojë marrëveshjen; dh) magjistrati tërheq pëlqimin për marrëveshjen. 7. Nëse Këshilli e pranon marrëveshjen, ajo do të konsiderohet si një vendim i formës së prerë i procedimit disiplinor, e cila nuk ankimohet. 8. Nëse Këshilli refuzon marrëveshjen, atëherë çdo pohim i bërë nga palët që lidhet me shkeljen disiplinore, në kuadër të hartimit të marrëveshjes, si dhe para Këshillit gjatë seancës për pranimin ose jo të marrëveshjes, nuk mund të përdoret në favor ose kundër këtyre palëve. 9. Nëse marrëveshja refuzohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të fillojë ose vazhdojë veprimet hetimore disiplinore ndaj magjistratit, brenda një muaji nga dita e refuzimit të kësaj marrëveshje. 10. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikën 9, të këtij neni, magjistrati ka të drejtë të ankimohet mosveprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.”

## **Kodi i Etikës Gjyqësore<sup>5</sup>**

31. Në rastin konkret është i zbatueshëm edhe Kodi i Etikës Gjyqësore, i cili në Kreun II, titulluar “Parimet bazë të Kodit të Etikës Gjyqësore” dhe specifikisht në Seksionin “C”, titulluar “Parimi i integritetit”, parashikon se: “8. Gjyqtari sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në funksion dhe paanshmërinë e pavarësinë e gjyqësorit. Sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek integriteti i gjyqësorit. Sipas këtij parimi, gjyqtari: a) kujdeset për ruajtjen e integritetit si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor; b) sigurohet që sjellja e tij të jetë dinjitoze në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm;...”;

---

<sup>5</sup> Miratuar me Vendimin nr.171, datë 22.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 29 prill 2021.

32. Gjithashtu, në Kreun II, titulluar “Parimet bazë të Kodit të Etikës Gjyqësore” dhe konkretisht në Seksionin “Ç”, titulluar “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërbajtje”, parashikohet se: “9. Gjyqtari shmang sjelljen e pahijshme dhe shfaqjen e saj në të gjitha aktivitetet e tij. Si subjekt i vëzhgimit të vazhdueshëm publik, gjyqtari duhet të pranojë kufizime personale që mund të shihen si të paarsyeshme për një qytetar të thjeshtë dhe këtë duhet ta bëjë lirshëm dhe me dëshirë. Gjyqtari shmang çdo sjellje, e cila krijon dyshimin e arsyeshëm se vendimet e tij nxiten nga motive të tjera, përtej zbatimit të drejtë të ligjit. Gjyqtari sillet me vetëpërbajtje me synim arritjen e një balance mes të drejtave të tij si qytetar dhe kufizimeve që lidhen me funksionin e tij. Sipas këtij parimi, gjyqtari: ...c) nuk lejon që zyra e tij të përdoret për qëllime të tjera të ndryshme nga ato që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore; ...”.

## **V. VLERËSIMI I KËSHILLI TË LARTË GJYQËSOR**

33. Sipas nenit 147, pika 1 e Kushtetutës, Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi i vetëm kushtetues, që siguron, jo vetëm pavarësinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, por dhe përgjegjshmërinë e tij. Parashikimet kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, të cilat janë hetimi disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor, i cili do të shqyrtohet dhe vendoset vetëm nga Këshilli.

34. Në lidhje me procedimet disiplinore të gjyqtarëve, neni 140 i Kushtetutës përcakton se gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit, duke ia lënë ligjvënësit kompetencën e vendosjes së veprimeve ose mosveprimeve që duhet të konsiderohen si shkelje disiplinore dhe, duke e kufizuar këtë autorizim apo delegim vetëm për shkeljet të cilat pasjellin shkarkimin e gjyqtarit nga detyra. Në zbatim të këtij parashikimi kushtetues është miratuar Ligji për Statusin, i cili normon parimet e procedimit disiplinor, llojet e shkeljeve dhe të masave disiplinore që mund të caktohen ndaj magistratit, si dhe procedurat hetimore dhe disiplinore që ndiqen ndaj tij nga organet e ushtrimit të ndjekjes disiplinore.

35. Për shkelje të funksioneve të tyre gjyqtarët mund të mbajnë përgjegjësi disiplinore, por dhe penale. Sjellja e gjyqtarëve, lidhur me veprimtarinë e tyre, në kryerjen e detyrave funksionale, si dhe për veprimtaritë jashtë ushtrimit të detyrës, nuk duhet të krijojnë dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, me qëllim për të rritur përgjegjshmërinë në ushtrimin e detyrës si dhe për të rritur besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

36. Bazuar në këto dispozita kushtetuese dhe ligjore, Këshilli vlerëson se vendosja e një mase disiplinore ndaj një gjyqtari duhet të jepet gjithnjë dhe vetëm në kuadër të një procedimi disiplinor, të filluar nga organi kompetent dhe të shqyrtuar sipas procedurave të parashikuara në Ligjin për Statusin, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të parimeve të procedimit

disiplinor, si të parimit të ligjshmërisë, të akuzës, të barazisë para ligjit, të prezumimit të pafajësisë, të proporcionalitetit etj.

37. Në kuadër të procedurave të parashikuara me ligj, në nenin 135 të Ligjit për Statusin ka gjetur pasqyrim dhe instituti më i ri ligjor në fushën e procedimeve disiplinore, i titulluar “Marrëveshja e Përbashkët e Pranimit”, sipas të cilit Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit. Në këtë marrëveshje palët bien dakord për llojin e shkeljes disiplinore që magjistrati ka pranuar, si dhe masën disiplinore më të përshtatshme. Si e tillë marrëveshja e përbashkët e pranimit ka si qëllim përshpejtimin dhe efektivitetin e procedurave të procedimeve disiplinore para Këshillit, si dhe shmangies së ankimeve përpara Gjykatës kompetente.

38. Marrëveshja, në referim të pikës 3 të nenit 135 të Ligjit për Statusin, nga ana formale duhet të hartohet me shkrim dhe të nënshkruhet rregullisht nga palët e saj, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati i proceduar disiplinarisht, ndërsa në referim të pikës 4 të po të këtij ligji, në lidhje me përmbajtjen e tij, ky akt duhet të përmbajë një përmbledhje të fakteve dhe shkeljeve disiplinore që pranohen nga magjistrati; masën disiplinore konkrete që palët kanë rënë dakord; si dhe një deklaratë me anë të së cilës magjistrati shpreh qëndrimin se është i vetëdijshëm se marrëveshja duhet të miratohet nga Këshilli.

39. Referuar aktit nr. 2569/45 prot., datë 05.01.2022, të titulluar “Marrëveshje e Përbashkët e Pranimit”, rezulton i qartë plotësimi i këtyre elementëve ligjorë<sup>6</sup>, siç janë nënshkrimi në tërësi i aktit nga subjektet e saj, pasqyrimi i hollësishëm i rrethanave të faktit siç pretendohen nga secila nga palët, përshkrimi i shkeljes, llojit të saj si dhe analiza e kriterëve për caktimin e masës disiplinore konkrete. Gjithashtu, bashkë me marrëveshjen janë depozituar dhe dy deklaratë me shkrim të nënshkruara nga magjistratja, znj. {...}, ku pasqyrohen deklaratimet e saj se:

(i) ka kuptuar përmbajtjen e marrëveshjes;

(ii) jep pëlqimin me vullnetin e saj të lirë në lidhje me të;

(iii) se është e vetëdijshme se një marrëveshje e tillë duhet të miratohet nga Këshilli.

40. Në pikën 5 dhe 6 të nenit 135 të Ligjit për Statusin, përcaktohet kompetenca e Këshillit për të vlerësuar dhe verifikuar plotësimin e kushteve ligjore të marrëveshjes së paraqitur nga palët, vlerësim ky që do të orientojë Këshillin drejt pranimit apo refuzimit të saj. Këto kushte duhet të

---

<sup>6</sup> Neni 135, pika 4 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Marrëveshja duhet të përmbajë: a) përmbledhje të fakteve dhe shkeljes që pranon magjistrati; b) masën disiplinore që palët kanë rënë dakord; c) një deklaratë se magjistrati është i vetëdijshëm se marrëveshja duhet të miratohet nga Këshilli”.



plotësohen në mënyrë kumulative, pasi mosekzistenca e njërit prej kushteve mund të passjellë mospranimin e marrëveshjes së paraqitur nga palët.

41. *Kushti i parë* që duhet të plotësohet lidhet me faktin nëse marrëveshja është e nënshkruar nga të gjitha palët dhe nëse përmban të gjithë elementët e parashikuar në pikën 4, të nenit 135 të Ligjit për Statusin. Referuar rastit konkret, siç dhe u argumentua më lart, rezulton se “Marrëveshja e Përbashkët e Pranimit”, e depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i plotëson të gjitha këto elementë, duke e kualifikuar atë si të vlefshme për të vijuar me diskutimin e plotësimit të kushteve të tjera ligjore.

42. *Kushti i dytë* lidhet me verifikimin e faktit nëse magjistrati e ka kuptuar marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj si dhe nëse magjistrati e ka dhënë pëlqimin me shkrim për marrëveshjen e arritur me vullnetin e tij të lirë. Nga të dhënat e rezultuara nga raporti i hetimit, dosja hetimore dhe nga zhvillimi i seancës dëgjimore, del në pah, jo vetëm të kuptuarit e qëllimit të marrëveshjes së lidhur dhe përmbajtjes së saj nga magjistratja, znj. {...}, por dhe fakti që pëlqimi i dhënë, është i bazuar në vullnetin e saj të lirë dhe të pakontestueshëm. Ky përfundim i Këshillit mbështetet dhe gjendet i materializuar në disa akte shkresore të depozituara gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor, siç janë:

(i) kërkesa e depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2569/27, datë 30.09.2021, me anë të së cilës znj. {...} ka shprehur gadishmërinë për të diskutuar dhe dakortësuar arritjen e një marrëveshje për llojin e shkeljes dhe masës disiplinore;

(ii) deklaratimet e dhëna nga magjistratja gjatë hetimit disiplinor;

(iii) deklaratimet e magjistrates të pasqyruar në vetë përmbajtjen e marrëveshjes si dhe në deklaratat bashkëlidhur saj;

(iv) kërkesa e magjistrates drejtuar Këshillit me objekt, “Kërkesë për caktimin e seancës dëgjimore dhe heqjen dorë nga afati 15 ditor i mbrojtjes”, depozituar me nr. 2508/15 prot., datë 06.01.2022;

(v) deklaratimet e gjyqtarës gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 17.01.2022.

43. *Kushti i tretë* i përcaktuar nga ligji lidhur me vlefshmërinë e marrëveshjes së arritur është dhe verifikimi nëse masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakort Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati janë ose jo në përputhje me Ligjin për Statusin. Referuar “Marrëveshjes së Përbashkët të Pranimit”, rezulton që nga palët është dakordësuar për caktimin ndaj magjistrates, znj. {...}, të masës disiplinore të pezullimit nga detyra me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj. Në Ligjin për Statusin, ndërsa neni 105 i tij jep një listim të thjeshtë të llojeve të masave disiplinore, nenet 106 – 114 të tij, shtjellojnë dhe japin kuptimin e secilës prej tyre. Në vijim, neni 115 i ligjit vendos kriteret, të cilat duhet të vlerësohen nga organet disiplinore për të përcaktuar rëndësinë e shkeljes dhe për rrjedhojë dhe të llojit të masës konkrete disiplinore.

43.1 Konstatohet se *masa disiplinore e pezullimit nga detyra e magjistratit me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore të caktuar*, është një nga llojet e masave disiplinore

të parashikuara si në nenin 105, pika 1 shkronja “d” ashtu dhe në nenin 110 të Ligjit për Statusin. Një masë e tillë vendoset në rastet: a) kur shkelja është shumë e rëndë; b) kur Këshilli çmon se, pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar.

43.2 Në marrëveshjen e arritur midis palëve, pas analizës së detajuar të kriterëve përcaktuese të rëndësisë së shkeljeve disiplinore të kryera nga magjistratja, rezulton se palët kanë dakordësuar se veprimet/mosveprimet e magjistrates do të kategorizohen si “Shkelje shumë të rënda disiplinore”<sup>7</sup>. Po kështu, është vlerësuar se masat tjera, më të lehta disiplinore, të përcaktuara në ligj, do të ishin të papërshtatshme për rrethanat e shkeljes disiplinore<sup>8</sup>.

43.3 Gjithashtu, konstatohet se periudha e pezullimit nga detyra e magjistrates, për të cilën palët kanë rënë dakort, është brenda kufijve minimalë dhe maksimalë të përcaktuara në nenin 110 të Ligjit për Statusin. Sipas aktit “Marrëveshje e Përbashkët e Pranimit”, rezulton që nga palët është dakordësuar për caktimin ndaj magjistrates znj. {...} të masës disiplinore të pezullimit nga detyra me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj. Kjo periudhë është vlerësuar si e përshtatshme dhe në përputhje me rëndësinë e shkeljes së kryer, me rrethanat lehtësuese dhe rënduese të konstatuara gjatë hetimit disiplinor si dhe me kohëzgjatjen e pezullimit nga detyra, të vendosur ndaj magjistrates me vendimin nr. 240, datë 07.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

43.4 Bazuar sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në përfundimin se masa disiplinore e pezullimit nga detyra të magjistrates, znj. {...}, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë 6 muaj, është caktuar në zbatim të parimit të ligjshmërisë, i cili kërkon jo vetëm që shkelja dhe masa disiplinore të përcaktohen nga ligji, por kërkon gjithashtu caktimin e asaj mase disiplinore që është e domosdoshme dhe e dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor të filluar, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer magjistratja. Ky qëndrim ligjor është dhe rrjedhim logjik i zbatimit të parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizimit dhe proporcionalitetit. Masa e dakordësuar sipas marrëveshjes përbën një nga llojet e masave disiplinore të parashikuara konkretisht në nenin 105, pika 1 shkronja “d” të Ligjit për Statusin, si dhe është caktuar në përmbushje të përcaktimeve ligjore të vendosura në nenet 110 dhe 115 të Ligjit, si dhe në respektim të parimeve si më lart cituar.

44. Në vijim, pika 6 e nenit 135 të Ligjit për Statusin, përcakton se kërkesa për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit refuzohet nga Këshilli, kur konstatohet se:

---

<sup>7</sup> Shih pikën 15.17 të “Marrëveshjes së Përbashkët të Pranimit”, me nr. 2569/45 prot., datë 05.01.2022.

<sup>8</sup> Shih pikën 15.25 të “Marrëveshjes së Përbashkët të Pranimit”, me nr. 2569/45 prot., datë 05.01.2022.

- (i) marrëveshja nuk nënshkruhet nga të gjitha palët ose nuk përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;
- (ii) magjistrati i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në seancë dhe nuk paraqet shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij;
- (iii) magjistrati tërheq pëlqimin për marrëveshjen, si dhe nëse vlerësohet se:
  - (i) provat e mbledhura janë në kundërshtim haptazi me deklarinimin e magjistratit për pranimin e kryerjes së shkeljes disiplinore;
  - (ii) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, nuk janë në përputhje me Ligjin për Statusin;
  - (iii) magjistrati është detyruar të pranojë marrëveshjen.

45. Gjatë seancës dëgjimore, u konstatua mosekzistenca e kushteve ligjore të sipërcituara, që do të passillnin refuzimin e marrëveshjes nga Këshilli. Kështu rezultoi e provuar se marrëveshja është e nënshkruar rregullisht nga palët dhe përmban të gjithë elementët e përcaktuar në pikën 4 të nenit 135 të ligjit për Statusin dhe magjistratja mori pjesë rregullisht në seancën dëgjimore duke shprehur lirisht dhe qartë vullnetin e saj dhe nuk parashitroi ndonjë kërkesë apo deklaratë për tërheqjen e pëlqimit të dhënë për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, referuar analizës së rrethanave të faktit, të dala në bazë të provave të administruara gjatë fazës së hetimit disiplinor, si dhe shkeljeve disiplinore të pranuar nga magjistratja, nuk rezultoi e provuar që deklarimi i magjistrates për pranimin e kryerjes së shkeljes disiplinore të jetë në kundërshtim me provat e mbledhura si dhe nga tërësia e tyre nuk provohet që magjistratja znj. {...} të jetë vendosur në kushtet për të qenë e detyruar për të pranuar marrëveshjen sipas përmbajtjes së saj. Rezultoi gjithashtu, në referim të analizës ligjore të cituar më lart, se masa disiplinore për të cilën palët kanë rënë dakort në rastin konkret, është në përputhje me ligjin për Statusin.

46. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për miratimin e “Marrëveshjes së përbashkët të pranimit”, sipas aktit me nr. 2569/45 prot., datë 05.01.2022, plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 135 të Ligjit për Statusin, dhe si e tillë ajo duhet të miratohet nga Këshilli sipas përmbajtjes dhe disponimeve të dakordësuara midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates znj. {...}.

47. Këshilli i Lartë Gjyqësor konkludon se magjistratja znj. {...}, me veprimet/mosveprimet e saj, ka konsumuar shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 103, shkronja “dh” e Ligjit për Statusin, si dhe nga Seksioni “C”, shkronja “a” dhe “b” dhe Seksioni “Ç”, pika 9, shkronja “c” e Kodit të Etikës Gjyqësore. Veprimet/mosveprimet dhe sjelljet e magjistrates janë vlerësuar si shkelje shumë të rënda disiplinore, vlerësuar në raport të drejtë me natyrën e shkeljes disiplinore, shkallën e fajësisë, përvojën dhe pozicionin e magjistrates në sistem si dhe shkallën e dëmtimit të imazhit apo pasojave të ardhura ose që mund të vinin nga veprimet ose mosveprimet konkrete të magjistrates.

48. Bazuar në marrëveshjen e përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore, referuar të gjitha fakteve të provuara si dhe kritereve ligjore, të cilat përcaktojnë rëndësinë e shkeljes, si dhe rrethanave lehtësuese e rënduese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me miratimin e marrëveshjes, vendosi se ndaj magjistrates znj. {...}, do të duhet të caktohet masa disiplinore e “Pezullimit nga detyra me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “d”, dhe neni 110 i Ligjit për Statusin, si masa e dakordësuar midis palëve dhe e vlerësuar nga Këshilli si në përputhje me ligjin dhe në zbatim të përshtatshëm dhe të balancuar të parimeve të drejtësisë, objektivitetit, individualizimit dhe proporcionalitetit, duke e konsideruar shkeljen e kryer nga magjistratja shumë të rëndë, të tillë që pavarësisht se rrethanat e kryerjes së saj nuk e bëjnë magjistraten të papërshtatshme ose të padenjë për të vijuar ushtrimin e funksionit, rëndësia e shkeljes së kryer dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistratja të pezullohet për një kohë të caktuar.

49. Referuar pikës 7 të nenit 135 të Ligjit për Statusin, Këshilli vlerëson se ky vendim për miratimin e marrëveshjes së dakordësuar midis palëve, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates znj. {...}, do të konsiderohet si një vendim i formës së prerë i procedimit disiplinor dhe ndaj tij nuk mund të ushtrohet ankim.

## **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 140, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 103, shkronja “dh”, nenin 105, pika 1, shkronja “d”, nenin 110 dhe nenin 135 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në Seksionin “C”, shkronja “a” dhe “b” dhe Seksionin “Ç”, pika 9, shkronja “c”, të Kodit të Etikës Gjyqësore, nenin 86, shkronja “e” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **V E N D O S I:**

1. Miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit, dakordësuar midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, lidhur me procedimin disiplinor nr. 3/2021. Kjo marrëveshje është pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Ky vendim është i formës së prerë lidhur me procedimin disiplinor nr. 3/2021, e si i tillë nuk ankimohet.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magjistrates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publike në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**